



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. nr.2344 datë 30.08.2013

Për

“Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Albtelecom sh.a per Shfuqizimin/Ndryshimin e Vendimit nr. 2325, datë 28.06.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban Karapici	Anëtar
3. Z. Benon Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 30.08.2013, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Shqyrtimin e ankimimit administrativ të Albtelecom sh.a në lidhje me Shfuqizimin/Ndryshimin e Vendimit nr. 2325, datë 28.06.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit””

BAZA LIGJORE:

1. Nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji nr. 9918, i ndryshuar**);

2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**K.Pr.A**);
3. Rregullore nr. 19 datë 14.06.2010 për “Aksesin dhe Interkoneksionin” miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010, e ndryshuar (**Rregullorja**);
4. Vendimi nr. 2325, datë 28.06.2013 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit”, (**Vendimi nr. 2325**),

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa nr. 4607 prot, datë 29.07.2013 e Albtelecom sh.a, (AKEP: nr. 1333 prot, datë 31.07.2013), (**Ankim Administrativ**);
2. Vendimi nr. 2325, datë 28.06.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit”, (**Vendimi nr. 2325**);
3. Projektvendim i Këshillit Drejtues të AKEP „Për Shqyrtimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a në lidhje me Shfuqizimin e Vendimit nr. 2325, datë 28.06.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit” dhe pranimin e ankimit;
4. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**);
si dhe,
6. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

1. Albtelecom me shkresën nr. 4607 prot, datë 29.07.2013 (AKEP: nr. 1333 prot, datë 31.07.2013), brënda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 140 të ligjit nr.8485, ka bërë ankim administrativ për shfuqizimin/modifikimin e Aktit Administrativ Vendimi nr. 2325, datë 28.06.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit”;
2. Albtelecom sqaron se, kërkesa për shfuqizimin e Vendimit nr. 2325 të KD të AKEP, lidhet me ndryshimin në mënyrë të ndjeshme të rrjetit të Albtelecom që sjell ndryshime në treg dhe efekte financiare shtesë të përballuara nga Albtelecom, me ruajtjen e 12 zonave rajonale të interkoneksionit në zbatim të Vendimit nr. 2325 të KD të AKEP edhe pas kalimit në rrjetin NGN;
3. Albtelecom thekson se, me përfundimin e procesit të migrimit në rrjetin e NGN, arkitektura e re e rrjetit sjell efekte në interkoneksion mes rrjeteve në të gjithë

operatorët për shkak të ndryshimit të topologjisë së rrjetit dhe heqjen nga përdorimi të të gjithë centraleve TDM duke u përqëndruar vetëm në 2 centrale softëich në Tiranë dhe Durrës. Ndërkohë interkoneksioni në 12 pika me operatorët e tjerë kur Albtelecom ka hequr nga funksionimi centralet TDM, sjell për Albtelecom kosto shtesë financiare për transportimin e trafikut si për origjinimin ashtu edhe terminimin nga pikat e interkoneksionit nga ku kërkohet të bëhet lidhja nga operatorët e tjerë deri në centralet tranzite;

4. Albtelecom bënë me dije se ka mbajtur vazhdimisht të informuar AKEP në lidhje me ndryshimet e rrjetit të Albtelecom të cilat kanë filluar që prej vitit 2009, ndryshime të cilat kanë qënë të paralajmeruara për të gjithë sipërmarresit në treg dhe të gjithë aktorët e prekur nga keto ndryshime do duhej të ishin të përgatitur për efektet e pritshme;
5. Albtelecom ka kërkuar amendimin e ORI të Albtelecom për të pasqyruar ndryshimet e mësipërme në zbatim të pikes 3 dhe 5 të nenit 5 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 i ndryshuar, si edhe pikes 8 të nenit 6 të Rregullores nr. 19 datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”;
6. Albtelecom thekson se, në ligjin nr. 9918 i ndryshuar, përcaktohet qartësisht se AKEP imponon ndryshimin e ofertës referencë të paraqitur, nese kjo e fundit nuk plotëson më kërkesa, që lidhen me kushtet e veçanta për arsyeshmerinë dhe grafikun kohor. Albtelecom në lidhje me këto kritere të përcaktuara në ligj dhe në zbatim të rregullores “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, është i legjitimuar të kërkojë keto ndryshime por edhe të pezullojë shërbimet e interkoneksionit i detyruar nga heqja prej funksionimit të disa centraleve TDM. Në respekt të pergjigjes së AKEP ndaj njoftimit të Albtelecom për sipërmarrësit në treg lidhur me keto ndryshime në rrjet, është i gatshëm të korrigjojë këtë element procedural dhe të zbatojë afatin 6 mujor që nga data e njoftimit fillestar për këto ndryshime;
7. Albtelecom vlerëson se, kërkesa për ndryshimin e ORI vjen si një domosdoshmëri e kohës dhe jo vetëm e ndryshimeve thelbësore në rrjetin e Albtelecom por edhe ndryshimeve dinamike në tërësi në tregun e komunikimeve elektronike. Një pjesë e rëndësishme e detyrimeve dhe rregullave të vendosura ndaj Albtelecom me VKD nr. 1348, datë 26.07.2010 dhe materializuara në ORI të Albtelecom nuk i përgjigjen situatës aktuale të rrjeteve, ndaj kërkesa e Albtelecom për amendimin e ORI është një shprehje e nevojës për të lehtësuar këto ndryshime dhe për të sjellë më tepër efikasitet në ofrimin e shërbimeve;
8. Gjithashtu edhe në zbatim në nenit 34 të Ligjit nr. 9918 i ndryshuar, ku përcaktohet se AKEP kryhen në intervale të rregullta, por jo më pak se njëherë në 2 vjet analizën e tregjeve përkatëse kërkohet përditësimi i detyrimeve për operatorët sipas ndryshimeve në tregun përkatës, Albtelecom vlerëson se ka përcjellë në kohën dhe formën e duhur pikpamjet e tij lidhur me këto ndryshime rregullatore në kushtet aktuale dhe kërkesa për ndryshimin e ORI përputhet plotësisht me linjen e këtyre pikpamjeve;
9. Albtelecom kërkon:
 - a) Shfuqizimin/revokimin e aktit administrativ Vendimit nr. 2325, datë 28.06.2013 të KD të AKEP “Për shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit” dhe pranimin e ankimit, përkatësisht në lidhje me:

- Përditësimin e ofertës referencë të Albtelcom për reduktimin e pikave të interkoneksionit të ofruara nga Albtelcom në vetëm 2 pika Kombëtare, 2 pika Rajonale dhe 2 pika Lokale brenda secilës nga këto pika Rajonale;
- b) Edhe në rastin kur AKEP do të konsideronte se ruajtja e 12 pikave rajonale të aksesit për operatorët alternativë do të ishte e nevojshme, detyrimi i Albtelcom mund të jete vetëm terminimi i trafikut të dorëzuar lokalisht drejt rangjeve të numrave të rajonit përkatës, dhe jo bartja e trafikut të tyre në të gjithë rrjetin e Albtelcom dhe rrjeteve të tjera. Do të duhej te ishte në zgjedhjen e këtyre operatorëve nëse do të interkonektoheshin direkt ne centralet e Albtelcom, apo do të përdornin pikat e aksesit dhe më pas do të merrnin me qera kapacitet për bartjen e trafikut nga pikat e aksesit drejt centraleve përkatëse, ndaj për sa më sipër Albtelcom kërkon në mënyrë alternative ndaj pikës së parë:
- Ndryshimin e aktit administrativ dhe përditësimin e RIO-s së Albtelcom për detyrimin e operatorëve të interkonektuar me Albtelcom për përballimin e kostos financiare të transportimit të trafikut nga 12 pikat e interkoneksionit deri në centralet tranzite ku kryhen funksionet e interkoneksionit.

10. Për sa më sipër ankimuar, AKEP vlerëson se:

- a. Në lidhje me kërkesat (pikat 7 dhe 8 më sipër) për rishikimin e detyrimeve të vendosura ndaj Albtelcom me VKD nr. 1348, datë 26.07.2010 të materializuara në ORI aktual të Albtelcom, AKEP sqaron se me VKD Nr. 2337, date 30.07.2013 ka shfuqizuar Vendimin nr. 1348, datë 26.07.2010 duke rishikuar midis të tjerave edhe detyrimet e Albtelcom për interkoneksionin dhe që prekin ORI të Albtelcom. Ndër këto ndryshime është edhe reduktimi i pikave të interkoneksionit të Albtelcom. Albtelcom do te kete detyrimin te ruaje/vazhdoje te jape akses per interkoneksion ne 12 pikat rajonale dhe 2 pikat kombetare te interkoneksionit por jo ne 68 pikat lokale te interkoneksionit. Ky reduktim i pikave të interkoneksionit dhe zvogëlimi i segmenteve të terminimit/origjinimit/tranzitimit përbën lehtësim të detyrimeve të Albtelcom.
- b. AKEP në dokumentin e Analizës së tregut të telefonisë fikse të miratuar me VKD nr. 2336, datë 30.07.2013, pasi ka marrë në konsideratë ndryshimet e ndodhura treg dhe në rrjetin Albtelcom, ka parashikuar që përvec reduktimit të segmenteve të terminimit/origjinimit/tranzitimit dhe pikave të interkoneksionit duke filluar nga 1.01.2014, në nje periudhë afat-mesme të kryhet kalimi ne 1 segment terminimi/origjinimi pas diskutimeve edhe me lojtaret e tregut dhe ne kuader te ndryshimeve ne interkoneksion per kalimin ne nivel IP. Ky kalim me faza është në linjë edhe me komentet e Albtelcom për anlizen e tregut të telefonisë fikse të nxejrrë në konsultim publik në Gusht 2012 si dhe në linjë me praktikat rregullatore në vende të tjera dhe

rekomandimet e ERG¹/BEREC për fazat tranzitore të migrimit të plotë në NGN.

- c. Sic është theksuar në VKD nr. 2325, datë 28.06.2013, bazuar në përcaktimet ligjore (neni 52 i Ligjit 9918) dhe të ofertës referencë të interkoneksionit, propozimi i Albtelecom për ndryshim të ORI është objekt i miratimit ose jo, apo imponimit të ndryshimeve nga AKEP. Në këto kushte AKEP ka ushtruar kopetencat e veta për mos-miratimin e ndryshimeve të propozuara nga Albtelecom pasi propozimi i Albtelecom nuk është i arsyeshëm në kushtet e tregut Shqiptar dhe grafiku kohor (afati 2 mujor) është shumë i shkurtër për ndryshime të tilla të mëdha. Njëkohësisht dhe afati 6 mujor i ndryshimeve të propozuara është shumë i shkurtër pasi nuk bëhet fjalë për një element të caktuar të rrjetit Albtelecom por për shumë elemente të rrjetit dhe që kanë impakte në shumë operatorë në treg.
- d. Sic është theksuar edhe VKD nr. 2325, datë 28.06.2013 dhe në dokumnetin final të analizës së tregut fiks të miratuar me VKD nr. 2336, datë 30.07.2013, AKEP do të nisë një process diskutimi me palët e interesuara për ndryshime të tjera (përvec atyre të miratuara nga analiza) në interkoneksion që do të duhet të kryhen në të ardhmen, në kushtet e kalimit të plotë në rrjetin NGN/NGA të Albtelecom. Ndryshimet që duhet të kryhen në interkoneksion për kalimin e plote të tij në nivel IP kanë një sërë implikimesh që do të duhet të diskutohen edhe me operatorët e tjerë në treg, të tilla si menyrat e interkonektimit (TDM-IP; IP-IP etj), pikat e interkonektimit, menyrat e pageses (CPP/RPP/Bill and Keep), cilesinë e shërbimit, standartet e përdorura etj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 i ndryshuar, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe në zbatim të shkronjës c) të nenit 8 dhe nenin 52 të ligjit nr. 9918 dhe Rregullores nr. 19 datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar,

V E N D O S :

1. Të rrëzojë kërkesën ankimore nr. 4607 prot, datë 29.07.2013 të Albtelecom sh.a. në lidhje me Vendimin nr.2325, datë 28.06.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP;

¹ ERG (08) 26 final NGN IP-IC CS 081016: *ERG considers that the maximum efficient number of PoI offered in NGNs should be used for applying the lowest interconnection rate accordingly, even in case where not all of these points are physically offered for interconnection.*

2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 2325, datë 28.06.2013 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a, mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit”;
3. Të njoftohet sipërmarrësi Albtelecom sh.a për zbatimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R E
Alketa MUKAVELATI

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Benon PALOKA
3. Elkeda DOMI
4. Zamira NURCE